

Rekomandime




Rekomandime



Të drejtat dhe përfaqësimi i punonjësve

Vendimmarrja e përbashkët




- Çdo vend i punës duhet të krijojë këshillin e punës i cili në përbërje duhet të ketë anëtarët sindikal me qëllim të kontribuojnë në organizimin e punës.
- Duhet të sigurohet që anëtarët e sindikatave ose janë të përfaqësuar në këshilla të punës ose kanë vendimmarrje në përzgjedhjen e tyre.
- Përfaqësimi i punëtorëve ose sindikatave në bordet drejtuese të të gjitha firmave duhet të bëhet i detyrueshëm (përmes kuotave).
- Në të gjitha nivelet, nga këshilli i punës deri te bordet e ndërmarrjeve, përfaqësimi duhet të marrë parasysh përfaqësimin gjinor.




Negocimi i pagave

- Sindikatat duhet të kenë një rol vendimtar në përcaktimin e pagës minimale, dhe ajo duhet të bëhet me një formulë të thjeshtë dhe transparente.
- Sindikatat duhet të mbështesin politikën e pagave që synojnë të ulin pabarazinë brenda vendit të punës me fokus në sektor privat.
- Partnerët social duhet të vendosin një pagë minimale për punëtorët që nuk janë standard (punësim i përkohshëm; punë me kohë të pjeshme).



Sigurimi shoqëror



- Sindikatat duhet të kundërshtojnë të gjitha idetë që vendosin përgjegjësi për menaxhimin dhe financimin e sigurimeve shoqërore vetëm tek punëdhënësit.
- Përkufizimi shumë kufizues i aksidenteve në punë duhet të kundërshtohet (p.sh., kur të drejtat e tilla nuk përfshijnë lëndimin në rrugën për në ose nga puna në shtëpi).
- Sindikatat dhe të gjithë partnerët socialë duhet të mbështesin reformat që synojnë të jetësojnë lejen e patransferueshme prindërore për baballarët.



Mbrojtja e punësimit

- Dialogu duhet të zhvillohet në nivel evropian për përcaktimin e të drejtave themelore të punës për punëtorët në distanca të gjata, duke përfshirë të drejtat e tyre për ditë pushimi.
- Të gjitha kontratat afatshkurtra duhet të llogariten në mënyrë kumulative dhe pas 3 viteve të akumuluarra të gjitha kontratat duhet të konsiderohen afatgjata.
- Sindikatat duhet të informohen zyrtarisht për të gjitha komunikimet e ndërlidhura me punësimin dhe shkarkimin.



Rritja e vetëdijes dhe shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme



- Sindikatat, OJQ-të, qeveria, dhe punëdhënësit duhet të pajisin punonjësit me informata për rolin pozitiv të sindikatave.
- Televizioni publik duhet të ndajë një kohë të caktuar pa pagesë për të ju mundësuar sindikatave të promovojnë rolin e tyre.
- Sindikatat dhe të gjithë partnerët socialë duhet të shtyjnë miratimin dhe nxitjen e shërbimeve publike universale të edukimit dhe kujdesit në fëmijëri të hershme.
- Sindikatat duhet të promovojnë gjykatat e specializuara (gjykatat e punës) për një sistem gjyqësor më efikas.

